



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia Org. Org. Unit	SA-02
Nr. i Faqeve Be. Stranica No. Pages	-03-
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	5851-2/23
Data:	08.12.23
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

DATE/A:	07.12.2023
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Visar Demiri Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit - Komuna e Vitisë
CC:	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për dhënien e pëlqimit për miratim të Projekt “Plani Zhvillimor Komunal i Vitisë 2023-2031” sipas kërkesës së datës 06.10.2023 dhe Nr. protokolli 5851/23

I nderuari z. Visar Demiri,

Bazuar në “Kërkesë për pëlqim për miratimin e dokumentit “Plani Zhvillimor i Komunës së Vitisë 2023-2031” e parashtruara nga Visar Demiri, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Vitisë të datës 06.10.2023 me Nr. Prot.:5851/23, Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke marrë për bazë Vendimin Nr. 21/3628/21 të datës 13.10.2021(MMPHI/DMMU), Pëlqimi Mjedisor për “Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Projekt- Plani Zhvillimor Komunal i Vitisë”, ka shqyrtuar Projekt “Plani Zhvillimor Komunal i Vitisë 2023-2031”, sipas Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe vendos sipas vendimit të bashkangjitur në këtë shkresë.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar nën 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare,Nr.7,01 Mars 2019), Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregullore (QRK) Nr. 04/2021 si dhe nën 9 paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nxjerrë:

V E N D I M

Për dhënien e pëlqimit për miratim të Plani Zhvillimor Komunal i Vitisë 2023-2031

Departamenti për Planifikim Hapësinor Ndërtim dhe Banim në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas verifikimit të përputhshmërisë së Projekt “Plani Zhvillimor Komunal i Vitisë 2023-2031”, me Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, “Plani Hapësinor i Kosovës - Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+”, dhe Udhëzimin Administrativ Nr. MMPH 08/2017 Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, jep pëlqim për miratim të “Plani Zhvillimor Komunal i Vitisë 2023-2031”.

A r s y e t i m

Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor - Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit – Komuna e Vitisë, me shkresë zyrtare të datës 06.10.2023 me Nr. protokolli 5851/23, kërkon nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit pëlqim për miratim të Projekt “Plani Zhvillimor Komunal i Vitisë 2023-2031” sipas procedurës ligjore, pas shqyrtimit publik të hapur më datën 18.11.2022 në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditëve.

Departamenti i Planifikimit Hapësinor Ndërtimit dhe Banimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas shqyrtimit dhe vlerësimit të Projekt “Plani Zhvillimor Komunal i Vitisë 2023-2031” dhe dokumentacionit përcjellës Raporti nga Shqyrtimi Publik, konstaton se ky dokument:

1. I plotëson kushtet ligjore mbi procedurat e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor të parapara me Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimin Administrativ MMPH-NR.11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal;
2. Është në pajtim me nenin 15 dhe 20 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor;
3. Në parim është në pajtim me “Plani Hapësinor i Kosovës - Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+”
4. Është në pajtim Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit – Komuna e Vitisë brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit të dokumentit të planifikimit hapësinor nga Kuvendi i Komunës duhet të dorëzoj në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës “Planin Zhvillimor Komunal i Vitisë 2023-2031”, me qëllim të sigurimit të saktësisë dhe kompletimit të dhënave të përfshira në bazën e të dhënave të planifikimit hapësinor.

Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor obligohet të respektoj Ligjin për Tokën bujqësore në fuqi gjatë zbatimit të zhvillimeve në Komunë duke përfshirë “Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031”.

Projekt “Plani Zhvillimor Komunal i Vitisë 2023-2031” duhet të dorëzohet në Departamentin për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës para se të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së Vendimit për miratim të Planit Zhvillimor të Komunës, në kuptim të nenit 81 të Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale .

Projekt “Plani Zhvillimor Komunal i Vitisë 2023-2031” duhet të përkthehet në gjuhën serbe ashtu si parashihet në nenin 5 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

- Në kuptim të neni 21. të Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, me Planin Zhvillimor Komunal nuk mund të lëshohen Kushtet ndërtimore!

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.